




PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TE VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA



MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE
MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA
MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE

Për: KOMUNA
Kryetari
Kryeshefi Ekzekutiv
Zyrtari Kryesor Financiar
Drejtorët

Nga: Mr. Haki Shatri, 
Ministër për Ekonomi dhe Financa

Data: 11 Qershor 2007

Lënda: QARKORJA BUXHETORE 2008/02- KOMUNAT
FINANCIMI FILLESTAR NDËR-QEVERITAR 2008-2010 DHE
INSTRUKSIONET RRETH SHQYRTIMIT TË PRIORITETEVE TË
BUXHETIT KOMUNAL

1. Qëllimi

Qarkorja buxhetore (QB) 2008/01- për komunat ka dhënë instruksionet fillestare, procedurat dhe orarin kohor për zhvillimin dhe përgatitjen e Buxhetit komunal 2008. Ndërsa, qëllimi i Qarkores Buxhetore 2008/02 është të ofrojë informata rreth kufijve fillestarë buxhetorë për secilën komunë mbi shpenzimet e përgjithshme për vitin 2008 si dhe të njoftojë komunat për projeksionet preliminare për vitet 2009-2010. Qarkoren buxhetore 2008/01- komunat, ju mund t'a gjeni të publikuar në web faqen e MEF-it (www.mfe-ks.org). Kjo është esenciale për të kuptuar dhe zhvilluar më mirë QB 2008/02. Me disa përjashtime, qarkorja e dytë buxhetore nuk do të përsëritë instruksionet dhe përkufizimet e pasqyruara në qarkoren buxhetore 2008/01.

Propozim buxheti komunal 2008 dhe projeksionet preliminare për 2009-2010 duhet të prezantohen në pakon e dokumenteve për dorëzim në Departamentin e Buxhetit Komunal/ MEF. Ndryshimet pas-statusore mund të rezultojnë me përgjegjësi dhe kosto shtesë, si p.sh me formimin e komunave të reja, do të adresohen nëpërmes të një procesi të veçantë dhe përmes udhëzimeve të nxjerra në një qarkore pasuese.

Qarkorja Buxhetore përmban prioritetet e përcaktuara nga Qeveria të cilat janë të përfshira në draft Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASh), dhe janë në përputhje me rekomandimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), të përfshira në draftin e Letrës së Qëllimit të mirë, që pritet të nënshkruhet së shpejti.

2. Sfondi - Financimi i përgjithshëm ndërqeveritar për komunat 2008-2010

Sivjet, është marrë vendimi për të bërë përshtatjet e parimeve të pjesëmarrjes konstante prej 22.5 % të të hyrave të projektuara vjetore, të buxhetit të përgjithshëm

për nivelin komunal në formë të Granteve¹. Qasja e re është aprovuar për qëllimet e buxhetit 2008 për të dy nivelet e qeverisë, që bazohet në parimin e ndarjes së shpenzimeve të gjithmbarshme buxhetore.. Kjo konsiston me kërkesat prioritare të Kosovës si dhe parametrat makro-ekonomik të përfshira në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH), të rekomanduara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN).

Bazuar në parametrat makro-ekonomik mbi bazën e nivelit të shpenzimeve, Komisioni i Granteve, në takimin e datës 11 Qershor 2007, ka aprovuar nivelin agregat të financimit ndërqeveritar për 2008 dhe shumat tentative për periudhën 2009-2010. Tabela 1 pasqyron vendimin e Komisionit të Granteve, që mund tu nënshtrohet ndryshimeve, në përputhje me korrigjimet e mundshme në projeksionet makro-fiskale, zhvillimeve rreth procesit të statusit dhe decentralizimit.

Tabela 1 - Financimi Ndërqeveritar për komuna 2008-2010

	2007 Rregullorja e buxhetit 2006/61	2008 Preliminare	2009 Projeksioni	2010 Projeksioni
Gjithsej shpenzimet buxhetore	717.5	740.3	748.4	751.7
Granti për komunat plus të hyrat vetanake komunale	164.2	178.2	180.2	181.3
Të hyrat vetanake komunale	28.0	37.5	38.0	38.5
Granti komunal	136.2	140.7	142.2	142.8
grantet komunale si % e shpenzimeve totale (duke mos përfshirë THV)	20%	20%	20%	20%

Gjithsej Grantet komunale	136.2	140.7	142.2	142.8
Arsimi	76.7	78.5	78.5	78.5
Shëndetësia	18.0	18.0	18.0	18.0
Granti i Përgjithshëm (prej të cilës)	41.5	44.2	45.7	46.3
- prej të cilës shuma Fikse	3.3	3.3	3.3	3.3
- dhe Granti Stimulues i Tatimit në Pronë	8.0	9	9.5	10.0
Gjithsej Financimi Komunal	164.2	178.2	180.2	181.3

Shënim: Shpenzimet totale buxhetore përjashtojnë financimet e dedikuara për qëllimet e veçanta (përfitimet sociale, prioritetet zhvillimore) dhe shpenzimet pas statusit.

Për buxhetin 2008 parashihet se, niveli nominal i granteve totale do të varet drejtpërdrejtë nga projeksioni i nivelit të shpenzimeve dhe jo i të hyrave. Pritet që pjesëmarrja e granteve komunale në shpenzimet buxhetore totale (dmth., 20%) do të mbetet konstante krahasuar me buxhetin e vitit 2007 .

Në përgjithësi, struktura e financimit ndërqeveritar në vitin 2008 parashihet të jetë e ngjashme me strukturën e Granteve si në vitet paraprake. Prandaj, grantet totale për qëllime specifike do të arrijnë në 78.5 milion euro për Grantin e Arsimit dhe 18 milion euro për Grantin e Shëndetësisë. Shuma e mbetur paraqet financimin me grantin e përgjithshëm, përfshirë pjesën e grantit stimulues të tatimit në pronë në shumë prej 9 milion euro.

Grantet qeveritare se bashku me të hyrat vetanake të gjeneruara në nivel komunal do të përbëjnë shumën totale të resurseve në dispozicion, të komunave për financimin e shpenzimeve buxhetore. Duhet të shqyrtohen mundësitë potenciale për përmirësimin e mobilizimit të të hyrave vetanake nga komunat, në përputhje me Udhëzimin Administrativ 2007/02 mbi të hyrat vetanake, tarifa, ngarkesa dhe gjoba. Theks të veçantë duhet kushtuar rritjes së shkallës mbi inkasimin e të hyrave nga tatimi në pronë.

¹ Strategjia Afatmesme Buxhetore Komunale, aprovuar nga Qeveria në vitin 2005

3. Kufijtë fillestarë të financimit komunal 2008-2010

Kufijtë fillestar për financimin ndërqeveritar në 2008, 2009 dhe 2010 për komunën tuaj, përfshirë këtu secilën kategori të Granteve dhe të hyrat e projektuara vetanake, janë dhënë në **Shtojcën A**. Komuna duhet t'ju përmbahet kufijve të gjithmbarshëm për secilin Grant dhe nivelin e planifikuar për të hyrat vetanake. Ndërsa projeksionet për vitet 2009-2010 do të jenë preliminare, është esenciale që të tri vitet të tregohen në planin buxhetor të Komunës. Shumat preliminare të Granteve janë në përputhje me: (a) Nivelet e gjithmbarshme të Granteve të treguara më lartë; dhe (b) parimet e shpërndarjes ashtu siç është miratuar nga Komisioni i Granteve. Shih **Shtojcën B** për kriteret dhe metodologjinë e shpërndarjes së granteve ndërqeveritare.

Qëllimi dhe strategjia shpenzuese për secilën kategori të Granteve mbetet relativisht e njëjtë, nëse krahasohet me vitet paraprake. **Shtojca C** ofron informata përcjellëse lidhur me këtë.

Në rast se do të ketë ndryshime në nivelet fillestare të Granteve të dhëna me këtë qarkore buxhetore, komunat do të njoftohen me kohë në përputhje me vendimin e Komisionit të Granteve.

4. Udhëzime për formulimin e Deklaratës strategjike komunale

Përgatitja e Deklaratës Strategjike ka për qëllim ta ndihmoj komunën tuaj në hartimin e dorëzimit buxhetor që i mbështet dhe është në përputhje me prioritetet komunale. Nëse komuna e juaj ende nuk e ka të hartuar strategjinë e cila paraqet mënyrën e shfrytëzimit të resurseve buxhetore dhe programet për arritjen e objektivave specifike që janë të ndërlidhura me misionin dhe synimet e komunës, atëherë informatat e kërkuara në Deklaratën Strategjike do t'ju ndihmojnë në hartimin e strategjisë për 2008 e më tutje.

Shtojca D ofron formatin për të plotësimin e deklaratës strategjike të komunës si bazë e kërkesës për dorëzim buxhetor për vitin 2008. Numrat dhe informatat e tjera në Formulimin e Strategjisë duhet të jenë në pajtim me elementet e tjera të kërkesave buxhetore.

Në veçanti.

Pjesa I. Kjo është formulim i qëllimeve dhe strategjisë së komunës tuaj. Ajo ju lejon juve që të përshkruani problemet me të cilat përballeni, duke përfshirë pengesat për të arritur qëllimet e komunës suaj, politikat vendimtare për të arritur këto qëllime dhe të tregojë se si kontribuojnë resurset që tani i përdorni për të arritur secilin qëllim. **Qëllimet** fokusohen në terme afatgjata dhe ndikojnë në drejtimin e progresit të caktuar, por zakonisht nuk kanë planin vjetor për arritje të suksesshme. Komuna e juaj do të ketë një apo numër të vogël të qëllimeve strategjike, të cilat do të listohen në rreshtin e parë.

Pjesa II. Kjo pjesë është formulim i më shumë Objektivave specifike që komuna e juaj ka për qëllim ti arrijë në vitin e ardhshëm apo brenda disa viteve me resurset të cilat propozohen në kërkesat buxhetore. Objektivat fokusohen në termat afat-mesme dhe duhet të jenë të lidhura me një nga qëllimet e cekura në Pjesën e I-rë. Duhet të përfshijë **vijën bazë** e cila përcakton sasinë e nivelit të tanishëm të arritjeve, **planin** (target) i cili përcakton nivelin e ardhshëm që komuna e juaj pret ta arrijë me resurset e kërkuara, dhe **planin vjetor** ku niveli i planit do të arrihet. Në këtë pjesë ju duhet të

vlerësoni shumë e buxhetit të juaj për vitin 2007 që ishte përdorur si ndihmë e këtyre objektivave (vetëm nëse është objektivë e vitit 2008). Kjo pjesë gjithashtu tregon se si organizata e juaj i përdorë resurset e saj buxhetore për të performuar aktivitetet të cilat kontribuojnë për qëllimet dhe objektivat e tyre. Për secilin objektiv, propozimet buxhetore 2008 duhet të ndahen në mes të shumës së resurseve të cilat mbështesin nivelin e tanishëm të shërbimeve dhe aktiviteteve dhe shumën shtesë që nevojitet për të përkrahur aktivitetet e reja ose një shkallë më të lartë të shërbimeve ose aktiviteteve për vitin 2008, 2009 dhe 2010.

Nëse keni pyetje sa i përket kompletimit të Formulimit të Strategjisë ose përdorimit të saj në proceset buxhetore, ju lutem të kontaktoni analistët e buxhetit komunal në MEF.

5. Caqet për shpenzimet rrjedhëse në vitin 2008

Shpenzimet rrjedhëse përfshijnë kategoritë ekonomike “paga dhe mëditje”; “mallra dhe shërbime”; “shërbime komunale”; dhe “subvencione e transfere.”

Ndonëse MEF-i nuk ka për qëllim të përcaktojë kufijtë e shpenzimeve komunale për kategoritë ekonomike, për të mundësuar kështu një shkallë të konsiderueshme të fleksibilitetit në planifikimin e buxhetit komunal, rekomandohet që komuna t’u jap përparësi të qartë shpenzimeve kapitale, ndërsa plani i saj për buxhetin periodik (shpenzimet rrjedhëse) nuk kalon nivelin e vitit 2007.

5.1 Strategjia e reduktimit të punësimit dhe faturës së pagave për vitin 2008

Procesi i reduktimit të personelit komunal i filluar në vitin 2006, sipas Letrës së Qëllimit të Mirë, të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës dhe komuniteti i donatorëve (nëntor 2005), do të vazhdojë edhe për vitin 2008. Nivelet e reduktimit të personelit komunal dhe pagave janë dhënë të bashkangjitura në Shtojcën A. Kufijtë preliminarë mund tu nënshtrohen ndryshimeve, me vazhdimin e punës që po bën Ministria e Shërbimeve Publike në reformën e shërbimit civil. Imperativ është që komuna e juaj ti respektoj plotësisht këta kufij.

Njëkohësisht, duhet respektuar kategoritë e mbrojtura (mjekët dhe mësimdhënësit) përfshirë këtu edhe personelin në Pilot Njësitë Komunale. Autoritetet komunale do të jenë kompetente dhe përgjegjëse për përcaktimin reduktimeve të nevojshme që duhet të bëhen sa i përket personelit administrativ në mënyrë që të arrihen kufijtë e përshkruar.

Duhet të merrni parasysh që:

- Komunat duhet të planifikojnë të arrijnë kufijtë e personelit në fund të vitit 2008, të dhëna në Shtojcën A.
- Për vitin 2008, komunat duhet të kenë parasysh që nuk do të kenë mundësi ti plotësojnë pozitat që pensionohen gjatë vitit, me përjashtim të kategorive të mbrojtura (mjekëve dhe mësimdhënësve) dhe Pilot Njësitë Komunale.
- Menaxhimi i implementimit të reduktimit agregat të kërkuar në përputhje me vet rrethanat e Komunës, me specifikat dhe nevojat e secilës drejtori dhe në pajtim me prioritetet komunale.
- Respektimi i rregullave për punësimin në shërbimin civil (dmth., pozitat, gradat, kompensimi, etj) si dhe sigurimi i standardeve të ofrimit të shërbimeve të përshkruara nga Ministritë përkatëse (psh. në sektorët e edukimit e shëndetësisë, zjarrfikësit, etj).

6. Shpenzimet kapitale

Ashtu si është deklaruar me Qarkoren Buxhetore 2008/01, Komuna duhet të sigurojë që plani i shpenzimeve kapitale për vitin 2008 do të zhvillohet në përputhje me:

- Strategjinë Zhvillimore të Komunës, me qëllim të adresimit të nevojave lokale për zhvillim dhe investime.
- Në pajtim me prioritetet e politikave të Qeverisë dhe (kur është e mundur) me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve. Organizatat buxhetore komunale duhet të synojnë përgatitjen e propozimeve kapitale që do të kontribuojnë në përmbushjen e synimeve prioritare të Qeverisë për vitin 2008

Kërkesat e para për shpenzimet kapitale do të jenë projektet e arsyetuara mirë dhe të vazhdueshme, që janë aprovuar në vitet paraprake ("vlerësimet e hershme"). Varësisht nga vlerësimet e hershme për komunën tuaj, kjo lë një shumë më të lartë apo më të ulët përbrenda kufirit për projektet e reja të mundshme kapitale, që do të financohen në vitin 2008.

Përzgjedhja e projekteve të reja kapitale për financim nga BKK do të varet nga disa faktorë:

- Projektet që u janë nënshtruar analizave të PIP-it do të merren parasysh për financim me buxhetin e vitit 2008. Asambleja Komunale duhet t'a aprovojë listën e projekteve me prioritet para dorëzimit të tyre në MEF.
- PIP duhet të përfshijë projektet e propozuara për financim në vitet 2008, 2009 dhe 2010, në përputhje me planin kapital tre vjeçar, të planifikuar nga Komuna.
- Formularët standard të kërkesave duhet të jenë të nënshkruara nga Kryeshefat Ekzekutiv dhe zyrtarët tjerë përkatës, në përputhje me procedurat, udhëzimet dhe adresimet gjegjëse.
- Nëse në vitet e ardhshme paraqiten shpenzime më të mëdha si rezultat i financimit kapital të vitit 2008 apo që rezultojnë nga vitet paraprake (p.sh. mirëmbajtja), ato shpenzime duhet të absorbohen brenda shumave totale për shpenzime të komunës.
- Parashtrime që duhet të tregohet, gjithashtu niveli i zotuar apo i pritur financimit nga donatorët ndërkombëtarë për projektin kapital të propozuar. Projektet meritore që kanë kaluar nëpër analizat e PIP-it, por që nuk përzgjidhen për financim nga Komuna, mund të merren parasysh nga donatorët ndërkombëtarë për financim potencial.

7. Programi i Investimeve publike (PIP)

Propozimet tuaja për shpenzimet kapitale duhet t'i ndjekin procedurat e paraqitura gjatë vitit 2006 me Programin e Investimeve Publike, në lidhje me buxhetimin e programeve dhe reformat e përgjegjësive që janë futur në përdorim nga komunat gjatë po atij viti. Këto janë shprehur qartë në **Manualin e Programit të Investimeve Publike për Komunat** (www.pip-ks.org). Trajnimi për PIP aktualisht është duke siguruar asistencë për zyrtarët buxhetor/financiar rreth përmirësimit të cilësisë së parashtrimeve të tyre, me fokusim kryesor në specifikimin e të gjitha përfitimeve që pritet të rrjedhin nga kostoja e projektuar e projektit, nga implementimi i tij në vitin vijues. Prandaj, nëse ka pyetje lidhur me procedurat, stafi juaj duhet të kontaktojë stafin e Departamentit të Buxhetit Komunal në MEF, por njëkohësisht duhet të ndjehen të lirë të kërkojnë udhëzime nga ekipi i ri i PIP-it, që i ka filluar aktivitetet e tij muajin e shkuar në fazën 2 të programit. Nëse komuna nuk është në gjendje të dorëzojë të gjitha propozimet për investime në formatin e PIP-it dhe në afatin e përcaktuar kohor, ajo duhet të fokusohet në arsyetimin e propozimeve të prioritetit më të lartë për të cilat kërkohet financim në kontekst të buxhetit 2008. Trajnimet tjera formale për PIP janë planifikuar për periudhën pas kompletimit të ciklit të tanishëm buxhetor në mbarim të shtatorit.

Megjithatë, në ndërkohë është me rëndësi që secila komunë të bëjë përzgjedhjen e propozim projekteve për PIP në përputhje me procedurat e PIP-it, prioritetet zhvillimore të komunës dhe të aprovuara nga Kuvendi Komunal

8. Sistemi për menaxhimin e të dhënave buxhetore (BDMS)

Ashtu si është theksuar në Qarkoren buxhetore 2008/01, sistemi BDMS do të përdoret ekskluzivisht për futjen e të dhënave të buxhetit 2008. Nga të gjitha komunat kërkohet të përdorin këtë sistem.

Për të lehtësuar përdorimin e BDMS, ju lutemi ofroni informatat në vijim: 1) emrat e plotë të të gjithë zyrtarëve që shfrytëzojnë sistemin; 2) emrin e përdoruesit; 3) kodin e organizatës buxhetore; dhe 4) të gjitha apo disa nga këto role (përdorues i fundit, vetëm për shikim, dhe me mundësi intervenimi). Informatat duhet të dorëzohen me email tek Arjeta Rukovci në arukovci@mfe-ks.org. Këto informata duhet të dërgohen sa më parë, por jo më larg se më 30 qershor 2007. Për të gjitha çështjet lidhur me BDMS, mund t'i kontaktoni analistët e Departamentit të Buxhetit Komunal apo tavolina ndihmëse mund të kontaktohet me email: bdms@mfe-ks.org apo me telefon 038/202 34 233.

9. Nënkodet e reja në Arsim dhe Shëndetësi për vitin 2008

Shtojca E (Tabela C) i nënvizon kategoritë ekonomike sipas drejtorive/programeve. Për herë të parë nën-kodet për programet në Drejtoritë e Arsimit dhe Shëndetësisë do të futen në përdorim me fillim në vitin 2008, për të avancuar buxhetimin e programeve Në kuadër të Drejtorisë Komunale të Arsimit përfshihen këto nën-programe, siç janë: Administrata Komunale e Arsimit, çerdhet dhe arsimi parafillor, arsimi fillor si dhe arsimi i mesëm. Në kuadër të Drejtorisë Komunale të Shëndetësisë përfshihen këto nën-programe siç janë: Administrata Komunale e shëndetësisë, Ambulancat, Qendrat Mjekësore Familjare (QMF) dhe Qendrat Kryesore Mjekësore Familjare (QKMF). Kjo nënkupton që për nënkodet e reja për Drejtoritë e Arsimit dhe Shëndetësisë të përgatiten PCF-2. Ky format i planifikimit dhe prezantimit të buxhetit është obligativ për të gjitha Komunat.

10. Burimet e financimit

Financimi i komunave përfshinë disa burime, siq janë: Grantet komunale, Të Hyrat Vetanake komunale, Participimi i qytetarëve dhe pjesa e donatorëve. Referohuni Udhëzimit Administrativ 2007/02 për definicionin e të hyrave vetanake.

Për të siguruar shqyrtim të duhur të parashtrimeve të tyre buxhetore, komunat duhet t'i ofrojnë vlerësimet raportuese për shpenzime nga të gjitha burimet e njohura apo të pritura të të hyrave për shpenzimet rrjedhëse dhe ato kapitale. Në mënyrë specifike, ju duhet të raportoni rreth vlerësimit të shpenzimeve që financohen nga donatorët ndërkombëtar (FDN) për vitin 2008.

Për qëllimet e transparencës së shtuar buxhetore, shpenzimet që rezultojnë nga financimi i donatorëve ndërkombëtarë do të tregohen në Rregulloren e Buxhetit 2008 si tabelë e veçantë. Kjo do të jetë diç shtesë në shpenzimet totale buxhetore të konsoliduara, krahasuar me mënyrën në të cilën janë përgatitur dhe prezantuar buxhetet në të kaluarën. Sidoqoftë, kufijtë e buxhetit të konsoliduar të vitit 2008 do të përshtaten për t'i akomoduar këto shpenzime plotësuese. (Shtojca A nuk i përfshin shumat shtesë që mund të rezultojnë nga ndryshimet e politikave).

Formularët në vijim duhet të përdoren për raportimin e të hyrave vetanake, përkatësisht financimin nga donatorët.

Shtojca F: Planin e të hyrave vetanake për 2008 përfshirë participimin e qytetarëve>Veç kësaj, komunitat mund të dorëzojnë shënime sqaruese, kopjet e marrëveshjeve Komunë - Komunitet, raportet etj).

Shtojca G: Financimi i donatorëve - përfshinë projektet që do të financohen ose do të bashkë-financohen nga donatorët.

11. Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale (KAB Komunale) 2008-2010

Duke zbatuar instruksionet nga Qarkorja buxhetore 2008/01-Komunat, menjëherë pas pranimit të informatave për nivelin e kufijve fillestar buxhetor, zyrtari kryesor financiar përgatit draft - KAB komunale dhe dorëzon/rekomandon përmes Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv në Komitetin për Politika dhe Financa (KPF).

Dokumenti i KAB komunale duhet të përgatitet në pajtim me modelin e dhënë në dokumentin e MEF të quajtur "Modeli i Kornizës afatmesme buxhetore komunale" që i është dhënë komunave vitin e kaluar.

Veprimi që kërkohet:

1. ZKF përgatit dhe dorëzon përmes Bordit të Drejtorëve dhe Komitetit për Politika dhe Financa, draftin e KAB komunale – deri më 20 qershor 2007.
2. Duhet mbajtur konsultimet me komunitetin dhe palët kyçe të përfshira, përfshirë këtu takimet publike për diskutimin e prioriteteve komunale dhe strategjive. Konsultimet me ZKF duhet të mbahen deri më 15 qershor, ndërsa konsultimet në KPF në mes 20 qershorit dhe 10 korrikut.
3. Aprovimi nga KPF, publikimi i KAB komunale dhe dorëzimi në MEF/Departamentin e Buxhetit Komunal (në kopje fizike dhe kopje elektronike), të nënshkruar nga Kryetari dhe Kryeshefi Ekzekutiv më së largu deri më 15 korrik 2007.
4. Ju lutemi vëreni që datat e mëhershme për veprimet e parashikuara, ashtu si janë përfshirë fillimisht në QB 2008/01, janë përshtatur për të reflektuar vonesat në marrjen e vendimeve nga Komisioni i Granteve.

12. Shqyrtimi i prioriteteve të Drejtorive komunale

Duke zbatuar instruksionet nga QB 2008/01-Komunat, autoritetet komunale duhet të bëjnë shqyrtimin e çështjeve rreth politikave dhe prioriteteve në fushat e përgjegjësisë të secilës Drejtori.

Programet ekzistuese në secilën drejtori duhet të vlerësohen në kontekst të objektivave dhe strategjive të gjithmbarshme që janë zhvilluar nga komuna. Në pajtim me prioritetet komunale, secila Drejtori duhet të sigurojë një listë përmbledhëse si dhe koston indikative të propozimeve për politikën e reja me prioritet që do të propozohen për procesin e buxhetit komunal 2008-2010 (që pritet të fillojnë në secilin vit), bashkë me opsionet potenciale për kursime në programet e prioritetit të ulët apo me performancë të dobët. Nëse propozimi apo opsioni aprovohet (në parim) nga Komiteti për Politika dhe Financa të Kuvendit Komunal gjatë këtij procesi fillestar për rishikimin e prioriteteve, Drejtoria do të duhet të bëjë një kërkesë më të hollësishme si pjesë e dorëzimit të materialeve buxhetore, më vonë gjatë procesit buxhetor.

Procesi i rishikimit të prioriteteve të Drejtorive Komunale duhet të udhëhiqet nga ZKF, përfshirë këtu sigurimin e instruksioneve lidhur me kompletimin e këtij shqyrtimi në formë të Qarkores interne buxhetore komunale 2008/01 është paraqitur në Shtojcën H

Veprimi që kërkohet:

1. ZKF nxjerr Qarkoren interne buxhetore komunale 2008/01 me të cilën ofrohen instruksionet për kompletimin e rishikimit të prioriteteve të drejtorive deri më 15 qershor 2007.
2. Drejtoritë duhet të përgatisin dorëzimin e shqyrtimit të prioriteteve jo më vonë se më 30 qershor 2007.
3. Komiteti për Politika dhe Financa të Kuvendit Komunal bën aprovimin e shqyrtimit të prioriteteve deri më 5 korrik 2007.
4. Komiteti për Politika dhe Financa mban takime konsultative me secilën nga Drejtoritë e Komunës. Qëllimi i këtyre takimeve do të jetë arritja e pajtimit rreth arsyeve për iniciativat rreth programeve/politikave të reja si dhe për koston indikative të tyre. (Sikur që është theksuar, në këtë fazë propozimet për programe duhet të identifikohen thjeshtë si propozime të "një linje" për tu mundësuar vendim-marrësve shqyrtimin e shpejtë të nevojave të shfaqura dhe prioriteteve si dhe për të përcaktuar se cilat projekte duhet të zhvillohen më tej gjatë hapave vijues.)

13 Organogrami komunal – Struktura e drejtorive

Nga komunat kërkohet të dorëzojnë organogramin e kompletuar të drejtorive komunale për vitin 2008 në Departamentin e Buxhetit Komunal - MEF. Struktura organizative duhet të aprovohet dhe nënshkruhet nga Kryetari dhe Kryeshefi Ekzekutiv.

Informatat nga Organogrami i drejtorive komunale do të përdoren me qëllim të implementimit të buxhetimit të drejtorive/programeve dhe kodeve të Thesarit, që do të mbështesin planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit komunal 2008.

14. Trajnimi

Ministria për Ekonomi dhe Financa do të sigurojë trajnim për komunat në lidhje me instruksionet e dhëna me këtë Qarkore. Kalendarit dhe agjenda për trajnimet përkatëse do të bëhet i ditur me një komunikim të veçantë.

Mr. Haki Shatri
Ministër për Ekonomi dhe Financa

SHTOJCAT:

Shtojca A – Kufijtë fillestar të financimit ndërqeveritar 2008-2010 për komunat

Shtojca B – Metodologjia për shpërndarjen e Granteve

Shtojca C – Qëllimi dhe strategjia shpenzuese për Grantet Komunale

Shtojca D – Deklarata Strategjike e zhvillimit komunal

Shtojca E - Pakoja e dorëzimit të kërkesave buxhetore 2008-2010

Shtojca F – Formulari për Të hyrat Vetanake në 2008

Shtojca G - Financimi i donatorëve 2008-2010

Shtojca H – Modeli i Qarkores interne buxhetore komunale 2008/01

Shtojca A

Shtojca A – Kufijtë fillestar të financimit ndërqeveritar 2008-2010 për komunat

Shtojca B

Metodologjia dhe kriteret për shpërndarjen e Granteve Komunale

1. Granti i përgjithshëm shpërndahet për komuna sipas kriterit bazë të vlerësimeve zyrtare të popullsisë të vitit 2001, me përshtatjen që bëhet në shumën fikse në dispozicion për të gjitha komunat:

- Secila Komunë merr shumën fikse prej 100,000 eurosh nga fondet që janë në dispozicion për Grantin e përgjithshëm
- Pjesa e mbetur e Grantit të përgjithshëm ndahet në mes Komunave bazuar në përqindjet e vlerësimeve të popullsisë nga viti 2001, ashtu si janë prezantuar në Tabelën B.1 më poshtë.

Tabela B.1 – Të dhënat zyrtare të popullsisë

Komuna	Popullsia (2001)	
	#	(%)
Gllgovc	60,000	2.7
Fushë Kosovë	35,000	1.6
Lipjan	75,000	3.4
Obiliq	26,000	1.2
Podujevë	117,000	5.2
Prishtinë	400,000	17.9
Shtime	28,000	1.3
Dragash	35,000	1.6
Prizren	220,000	9.8
Rahovec	63,000	2.8
Suharekë	80,000	3.6
Malishevë	52,000	2.3
Deçan	50,000	2.2
Gjakovë	115,000	5.1
Istog	44,000	2.0
Klinë	44,000	2.0
Pejë	115,000	5.1
Leposaviq	19,000	0.8
Mitrovicë	110,000	4.9
Skenderaj	56,000	2.5
Vushtrri	75,000	3.4
Zubin Potok	15,000	0.7
Zveçan	16,000	0.7
Gjilan	110,000	4.9
Kaçanik	43,000	1.9
Kamenicë	55,000	2.5
Novobërdë	5,000	0.2
Shtërpçë	11,000	0.5
Ferizaj	111,000	5.0
Viti	51,000	2.3
Gjithsej	2,236,000	100.0

2. Granti për Shëndetësi shpërndahet vetëm sipas përqindjes së popullsisë në Komunë, bazuar në vlerësimet zyrtare të popullsisë të vitit 2001 (shih Tabelën B.1).

3. Për Grantin e Arsimit përdoret formula e zhvilluar nga Banka Botërore që bën diferencimin e popullsisë shumicë dhe pakicë për të siguruar përqindjen e fondeve që janë në dispozicion me Grant për secilën Komunë.

- Formula e përdorur është me sa vijon:
 - **Pagat dhe Mëditjet:** numri i nxënësve pakicë dhe shumicë në komunë nga raporti zyrtar i MASHT-it i dorëzuar në MFE ndahen veçmas sipas proporcionit nxënës/mësimdhënës për atë lloj të popullatës. Numri rezultues i mësimdhënësve shumëzohet me pagën mesatare të mësimdhënësve në Kosovë.
 - **Proporcionet nxënës/ mësimdhënës janë përcaktuar nga formula e Bankës Botërore në 1 me 21.3 për nxënësit e popullatës shumicë dhe 1 me 14.2 për nxënësit e popullatës pakicë.**
 - **Formulat janë, si vijon:**

Numri i mësimdhënësve shumicë (NMSH) = Nr. i nxënësve shumicë (NNSH) / 21.3
(rrumbullakësuar)

Numri i mësimdhënësve pakicë (NMP) = Nr. i nxënësve pakicë (NNP) / 14.2
(rrumbullakësuar)

Kostoja për mësues (KPM) = (NMSH+NMP) x Paga mesatare kosovare/
mësimdhënës

- Numri i stafit administrativ dhe atij ndihmës siç është paraqitur në listën e pagave shumëzohet me pagën mesatare për të punësuar të administratës dhe atyre mbështetës.

- **Formula është:**

Kostoja për stafin ndihmës (KSN) = Numri i personelit Administrativ & ndihmës x
Paga/Personeli

Fatura totale e pagave (FP) = KPM + KSN = FP

- **Mallrat dhe Shërbimet:** shuma fikse për shkollë (500 Euro për secilën shkollë parashkollë dhe fillore, ndërsa 1,000 për shkollat e mesme) i shtohet shumës fikse për nxënës, e diferencuar sipas nxënësve shumicë e pakicë.
 - **Shumat fikse të mallrave e shërbimeve për nxënës janë përcaktuar nga formula e Bankës Botërore, në €18 për nxënësit shqiptarë dhe €22.5 për nxënësit e përkatësive tjera etnike.**
 - **Formula është:**

Mallra & Shërbime (MSH) = (NNSH x 18) + (NNP x 22.5) = MSh

- **Shpenzimet kapitale:** €5 për nxënës alokohen për komunat.

- **Formula është:**

Shpenzimet kapitale (ShK) = (NNSH + NNP) x 5 = ShK

- **Kalkulimet e Master Formulës:**

Nevoja e vlerësuar për arsim (NVA) = FP + MSh + ShK = NVA

NVA / totali i kombinuar i NVA të të gjitha komunave = Përqindja e financimit në
dispozicion nga Granti i Arsimit për atë Komunë.

Financimi i bazuar në proporcionin nxënës/ mësimdhënës paraqet afërsisht 75% të buxhetit të përgjithshëm të arsimit për Komunën.

Shtojca C

Qëllimi dhe strategjia shpenzuese për grantet komunale

C.1. Granti i Përgjithshëm

Granti i Përgjithshëm do të jetë në dispozicion për financimin e të gjitha aspekteve të funksionimeve komunale. Nga Komuna do të kërkohet që pas procesit të saj intern buxhetor, të identifikojë se ku do të bëhet shpenzimi i Grantit të përgjithshëm, përfshirë këtu përcaktimin e shpërndarjes së Grantit të përgjithshëm nëpër njësitë e komunës dhe shumat për secilën njësi.

Një pjesë e Grantit të përgjithshëm do të ndahet anash si program për **Stimulimin e Tatimit në Pronë** në pajtim me parimet e programit të reformuar stimulues të tatimit në pronë, të miratuar nga Komisioni i Granteve. Granti total i programit stimulues për tatimin në pronë për vitin 2008 është caktuar në 9 milion euro. Fondet stimuluese të tatimit në pronë do të jenë në dispozicion të Komunës vetëm atëherë kur Komuna të arrijë cakun e vjeljes së tatimit në pronë për vitin 2007 dhe do të ndahen në fillim të vitit 2008, kur të jetë bërë verifikimi i grumbullimit real gjatë vitit 2007. Komuna, pas procesit të saj intern buxhetor, të bëjë identifikimin e projekteve kapitale apo investuese që do të financohen nga fondet stimuluese të tatimit në pronë.

Pas vendimit të Komisionit të Granteve, fondet e programit stimulues të tatimit në pronë duhet të përdoren për investime kapitale, në përputhje me projektet specifike të aprovuara nga Kuvendi Komunal. Projektet kapitale duhet të përgatiten dhe aprovohen në pajtim me procedurat e PIP-it.

C.2. Grantet për arsim dhe shëndetësi

Vetëm shpenzimet për arsim dhe shëndetësi mund të buxhetohen nga këto dy Grante dhe jo për aktivitete të tjera. Grantet e Arsimit dhe Shëndetësisë do të strukturohen ashtu që Komuna do të përcaktojë se në cilat njësi të arsimit apo shëndetësisë (sikur që janë shkollat, përkatësisht shtëpitë e shëndetit) do të bëhet shpërndarja e Grantit dhe shumat që do të jenë në dispozicion me buxhet për secilën njësi. Grantet e arsimit dhe shëndetësisë është parashikuar të sigurojnë vetëm financimin normativ për shërbimet përkatëse. Nëse Grantet për arsim dhe shëndetësi nuk janë të mjaftueshme për të përmbushur nevojat në ato fusha, Granti i përgjithshëm dhe/apo të hyrat vetanake të komunës duhet të përdoren gjithashtu për përmbushjen e nevojave të rëndësishme shoqërore.

Rritjet eventuale të shpenzimeve që planifikohen në këto dy funksione duhet të reflektohen si vendime të Kuvendit Komunal.

Shtojca D

DEKLARATA STRATEGJIKE: Pjesa I – Planifikimi strategjik

Qëllimet e komunës tuaj	Situata e tanishme dhe çështjet themelore	Politikat themelore	Buxheti i përafërt 2008 i duhur për secilin qëllim të komunës
<p>Bëni listën e një apo më shumë qëllimeve strategjike që organizata juaj ka themeluar në pajtim me funksionet ligjore</p> <p>Shembull:</p> <p>Qëllimi 1: “Të përmirësojë shërbimet shëndetësore për të gjithë qytetarët e komunës</p> <p>Qëllimi 2: “Të përmirësojë arsimin në shkollat fillore dhe të mesme”</p>	<p>Përmbledhje e shkurtë e situatës së tanishme që ka të bëjë me qëllimet strategjike. (p.sh. cilat janë mjetet themelore të nevojshme për të arritur progresin drejt realizimit të secilit qëllim?)</p>	<p>Identifikimi i politikave kryesore, duke përfshirë ndonjë politikë të re të nevojshme për vitin 2008 dhe më tutje, të cilat janë të nevojshme për të arritur progresin e vazhdueshëm drejt secilës strategji.</p>	<p>Për secilin qëllim strategjik, të identifikohet buxheti i përafërt i komunës suaj i cili është i nevojshëm për vitin 2008 për arritjen e atij qëllimi.</p>

Pjesa II – Objektivat, Implementimi dhe Shpenzimet

Qëllimet strategjike (përsëritje nga kolona I e Pjesës I)	Objektivat	Masat implementuese	Nën-njësitë përgjegjëse brenda organizatave kryesore buxhetore	Buxheti i përafërt për vitin 2007 i nevojshëm për arritjen e objektivave	Buxheti i përafërt për vitin 2008 i propozuar për arritjen e objektivave	Buxheti i përafërt për vitin 2009-2010 i propozuar për arritjen e objektivave
<p>Përsëritni qëllimet siç janë të nënvizuara në Pjesën e I kolona 1.</p>	<p>Për secilin qëllim në Pjesën I, listoni një ose më shumë objektiva që mund të arrihen dhe të përcillen gjatë vitit buxhetor. Objektivat duhet të kenë lidhje me qëllimet dhe duhet të tregojnë shumën e progresit të pritur dhe nga cili vit.</p> <p>Shembull</p> <p>Objektivi: “Të rris përqindjen e fëmijëve të lindur të cilët mbijetojnë deri në moshën një vjeçare nga (x)deri në(y) në përqindje me 20zz</p>	<p>Masat implementuese përdoren për vlerësimin e progresit të organizatave buxhetore drejt arritjes së qëllimeve dhe objektivave. Implementimi i programit mund të matet në kontekst të të dhënave, proceseve, të dalurave dhe rezultateve. Në përgjithësi ekzistojnë dy lloje të masave implementuese: kuantitative dhe kualitative.</p>	<p>Për secilin objektivi, të identifikohet emri i nën-njësisë së Komunës i cili është përgjegjës për implementimin dhe arritjen e tij.</p>	<p>Për secilin objektivi, të identifikohet shuma buxhetore e përafërt për vitin 2007 që komuna juaj e ka dedikuar për arritjen e atij objektivit.</p>	<p>A) Përfshin shpenzimet e vlerësuara për vitin 2008 për të mirëmbajtur nivelin e shërbimeve në secilin program.</p> <p>B) Përfshin shpenzimet e vlerësuara për programet e reja, ose për veprimet prioritare të propozuara për vitin 2008.</p>	<p>A) Përfshin shpenzimet e vlerësuara për vitin 2009-10 për të mirëmbajtur nivelin ekzistues të shërbimeve në secilin program.</p> <p>B) Përfshin shpenzimet e vlerësuara për programet e reja, ose veprimet prioritare të propozuara për vitin 2009-10.</p>

Shtojca E

Pakoja e Dorëzimit të kërkesave buxhetore 2008-2010

1. Shkresa përcjellëse dorëzuar nga komuna (e nënshkruar nga Kryeshefi Ekzekutiv dhe ZKF)
2. Vendimi i Asamblesë Komunale mbi aprovimin e buxhetit komunal 2008
3. Tabela C e buxhetit me kategori ekonomike për vitin 2008
4. Tabela D, planifikimi i grantit dhe të hyrave vetanake për vitin 2008
5. Tabela E, shpërndarja e buxhetit 2008
6. Lista e projekteve kapitale për vitin 2008 të aprovuara sipas prioriteteve
7. Forma PIP për çdo projekt
8. Formulari i të hyrave vetanake komunale për vitin 2008 (OSR-8)
9. Plani vjetor i shpenzimeve kapitale për minoritete për vitin 2008 (NDF)
10. KAB Komunal
11. PCF-2 (nënkodet në Arsim dhe shëndetësi), PCF-3 (Drejtoritë/Programet) dhe PCF- 4 (total Komuna)
12. Organogrami –struktura e drejtorive komunale

Shtojca G

FINANCIMI NGA DONACIONET 2008-2010

KOMUNA:

DATA:

Donatori	Bashkë - financimi	Emri i Projektit	Qëllimi	Shuma (paraqit 2008, 2009, 2010 ndarazi)	Data e fillimit të projektit	Data e përfundimit të projektit

Shtojca H

MODELI I QARKORES INTERNE BUXHETORE KOMUNALE 2008/01

[të vendoset këtu.....logo e Komunës suaj.....]

Për: Drejtorët e Drejtorive
Udhëheqësit e Programeve

Nga: Zyrtari Kryesor Financiar
Komuna [... ju lutemi tregoni]

Data: [...ju lutemi tregoni]

Lënda: QARKORJA INTERNE BUXHETORE KOMUNALE 2008/01
PËRGATITJA E RISHIKIMIT TË PRIORITETEVE PËR BUXHETIN E
DREJTORIVE/PROGRAMEVE 2008-2010

1. Qëllimi

Qëllimi i kësaj Qarkoreje buxhetore është të njoftojë Drejtoritë rreth informatave që kërkohen dhe orarit kohor për kompletimin e procesit të rishikimit të prioriteteve nga Drejtoritë, për periudhën 2008-2010.

2. Sfondi

Me procesin e ri buxhetor kërkohet që buxheti komunal të zhvillohet sipas Kornizës afatmesme buxhetore komunale (KAB komunale). Qasja e KAB kërkon që Komuna të shqyrtojë më për së afërmi nevojat dhe të bëjë caktimin e prioriteteve për alokimet buxhetore, për të siguruar pajtueshmërinë me objektivat e saj ekonomike, fiskale e sociale. Rishikimi i prioriteteve nga Drejtoritë do të ofrojë mundësinë Drejtorive që të identifikojnë propozimet për shpenzime të prioritetit të lartë, bashkë me kursimet potenciale në programet e prioritetit të ulët apo me performansë të dobët, para se të bëhet përcaktimi i kufijve fillestar të buxhetit për secilën Drejtori. Gjatë periudhës maj – qershor 2007, komuna ka përgatitur Kornizën afatmesme buxhetore komunale në të cilën theksohen prioritetet për buxhetin 2008-2010. Këto prioritete janë:

Prioriteti 1: [...ju lutemi tregoni]

Prioriteti 2: [...ju lutemi tregoni]

Prioriteti 3: [...ju lutemi tregoni]

Drejtoritë duhet ti shfrytëzojnë këto prioritete të larta si udhërrëfyes në përgatitjen e Rishikimit të prioriteteve të tyre.

3. Shqyrtimi i prioriteteve të Drejtorive

Nga të gjitha Drejtoritë kërkohet të bëjnë rishikimin e programeve të tyre dhe prioriteteve të shfaqura në kontekst të prioriteteve buxhetore të komunës (shih më lartë).

Ky rishikim i prioriteteve do tu ofrojë mundësinë vendim-marrësve (Komitetit për Politika e Financa) që të bëjnë shqyrtimin e propozimeve të shkurtra nga Drejtoritë në një fazë të hershme dhe të identifikojnë ato propozime për të cilat do të kërkohet vlerësim më i hollësishëm në dorëzimet e plota buxhetore. Si të tilla, vetëm informata të shkurtra dhe arsye të kërkohen gjatë rishikimit të prioriteteve.

Formati për kompletimin e rishikimit është dhënë në **Shtojcën 1** me sa vijon:

Tabela 1: kërkon një deklaratë mbi strategjinë e Drejtorisë, me fokus në rezultatet që planifikohet të arrihen gjatë periudhës afatmesme.

Tabela 2: ofron listën e opsioneve për kursime. Opsioni për kursime mund të jetë (a) propozimi për reduktimin e shpenzimeve në një program të caktuar, për shkak të efikasitetit që propozohet apo reduktimeve në nivelin e shërbimeve apo (b) anulimi i propozuar i një programi që nuk është më i nevojshëm, ka performansë të dobët apo është me prioritet të ulët.

Tabela 3: ofron listën e propozimeve për politikat e reja prioritare të mundshme, për tu marrë parasysh për financim me buxhet. Politika e re përfshin zgjerimin e programeve ekzistuese apo vazhdimin e programeve që janë para përfundimit, si dhe programet apo projektet tërësisht të reja. Është me rëndësi që kjo përfshin gjithashtu cilëndo kërkesë për ri-ndarjen e resurseve për projektet kapitale. Vlerësimet fillestare (vetëm indikative) të kostos duhet të përfshihen poashtu.

Kompletimi i projekteve kapitale tanimë të filluar dhe/apo zotuar dhe atyre të ri-planifikuara nga viti paraprak, duhet të ketë prioritetin më të lartë për financimin e politikës së re.

Nuk është e domosdoshme që programet, projektet apo kursimet e reja të fillojnë në vitin 2008. Pasi që ky është një plan për periudhën 2008-2010, kursimi i propozuar apo projekti i ri mund të fillojë edhe më vonë.

Qëllimi i listës është të ndihmojë dhe të inkurajojë caktimin e prioriteteve (dhe ri-caktimin e tyre) për resurset buxhetore në programet që kanë si synim plotësimin e objektivave më të rëndësishme fiskale e sociale të Komunës.

4. Veprimi që kërkohet

Të gjitha Drejtoritë duhet të veprojnë në këtë mënyrë, me qëllim të kompletimit të rishikimit të prioriteteve:

1. Rishikimi i vlerësimeve të hershme të programeve ekzistuese, që janë përgatitur dhe përfshirë në dokumentin e KAB komunale.
2. Kompletimi i Tabelës 1 duke specifikuar prioritetet për periudhën 2008-2010.
3. Emërimi i grupit punues intern për rishikimin e të gjitha programeve dhe projekteve ekzistuese dhe të reja, në raport me prioritetet e komunës. Identifikimi i kursimeve dhe propozimeve për politikat e reja për secilën Drejtori – që janë ndryshime të propozuar në vlerësimet e hershme, duke përfshirë:

- a. Programet apo projektet që duhet të anulohen apo reduktohen gjatë periudhës 2008-2010 (Tabela 2).
 - b. Projektet apo programet e reja që janë në pajtim me prioritetet e komunës (Tabela 3).
 - c. Vazhdimi i projektit apo programit që është financuar në buxhetin e vitit 2007 por për të cilin nuk ka fonde në vlerësimet e hershme (Tabela 3).
 - d. Financimi i nevojshëm për shkak të mos përfundimit të projekteve kapitale që fillimisht janë planifikuar të kompletohen në vitin 2007 – duke reflektuar faktin që të gjitha ndarjet buxhetore të vitit 2007 skadojnë më 31 dhjetor 2007 dhe nuk do të ketë bartje të fondeve apo fonde të pashpenzuara, me përjashtim të të hyrave vetanake të komunës (Tabela 3).
 - e. Zgjerimi apo zhvillimi i mëtejshëm i programit apo projektit ekzistues (Tabela 3).
 - f. Financimi nga BKK në të ardhmen i ndonjë programi apo projekti që aktualisht financohet nga donatorët, përfshirë këtu kërkesën për financim nga BKK të shpenzimeve periodike që lidhen me projektet kapitale të financuara nga donatorët (Tabela 3).
4. Kompletimi i Tabelave 2 deri 3 bazuar në konkluzionet e grupit punues.
 5. Sigurimi i aprovimit intern për të gjitha propozimet dhe tabelat.
 6. Kompletimi dhe kthimi i të gjitha Tabelave tek ZKF deri më... **(Ju lutemi tregoni).**

SHTOJCA 1 - FORMULARËT PËR RISHIKIMIN E PRIORITETEVE NGA DREJTORITË
(Tabela 1, 2 dhe 3)

Tabela 1. Strategjia e Drejtorisë së...
Drejtoria e [...ju lutemi tregoni drejtorinë përkatëse-tuaj]

Përmbledhje e rrjedhimeve që kërkohet të arrihen (misioni/synimet):

Strategjia për arritjen e rrjedhimeve të dëshiruara (aktivitetet aktuale):

Vlerësimi i mundësive dhe kërcënimeve gjatë periudhës buxhetore:

Plani i propozuar për adresimin e mundësive dhe kërcënimeve (aktivitetet e propozuara për të ardhmen):

Tabela 2. Propozimet e Drejtorive për kursime (Kursimet indikative)

Emri i programit			
Shpjegimi i kursimeve:			
Kursimi potencial (Euro)	2008 Vlerësimi buxhetor	2009 Vlerësimi i hershëm	2010 Vlerësimi i hershëm
Paga dhe mëditje			
Mallra dhe shërbime			
Subvencione e Transfere			
Shpenzime kapitale			
Nën-Totali			

Emri i programit			
Shpjegimi i kursimeve:			
Kursimi potencial (Euro)	2008 Vlerësimi buxhetor	2009 Vlerësimi i hershëm	2010 Vlerësimi i hershëm
Paga dhe mëditje			
Mallra dhe shërbime			
Subvencione e Transfere			
Shpenzime kapitale			
Nën-Totali			

Emri i programit			
Shpjegimi i kursimeve:			
Kursimi potencial (Euro)	2008 Vlerësimi buxhetor	2009 Vlerësimi i hershëm	2010 Vlerësimi i hershëm
Paga dhe mëditje			
Mallra dhe shërbime			
Subvencione e Transfere			
Shpenzime kapitale			
Nën-Totali			

Tabela 3. Propozimet e Drejtorive për shpenzime të reja (kostoja indikative)

Emri i programit			
Radhitja e propozimit (sipas prioritetit)			
Arsyetimi (rrjedhimet që duhet të arrihen me politikën e re):			
Shpenzimet shtesë (Euro)	2008 Vlerësimi buxhetor	2009 Vlerësimi i hershëm	2010 Vlerësimi i hershëm
Paga dhe mëditje			
Mallra dhe shërbime			
Subvencione e Transfere			
Shpenzime kapitale			
Nën-Totali			

Emri i programit			
Radhitja e propozimit (sipas prioritetit)			
Arsyetimi (rrjedhimet që duhet të arrihen me politikën e re):			
Shpenzimet shtesë (Euro)	2008 Vlerësimi buxhetor	2009 Vlerësimi i hershëm	2010 Vlerësimi i hershëm
Paga dhe mëditje			
Mallra dhe shërbime			
Subvencione e Transfere			
Shpenzime kapitale			
Nën-Totali			

Emri i programit			
Radhitja e propozimit (sipas prioritetit)			
Arsyetimi (rrjedhimet që duhet të arrihen me politikën e re):			
Shpenzimet shtesë (Euro)	2008 Vlerësimi buxhetor	2009 Vlerësimi i hershëm	2010 Vlerësimi i hershëm
Paga dhe mëditje			
Mallra dhe shërbime			
Subvencione e Transfere			
Shpenzime kapitale			
Nën-Totali			